

VENDIM

Nr. 149, datë 29.10.2012

PËR NJË NDRYSHIM TË PIKËS 2 TË VENDIMIT NR. 143, DATË 24.10.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “dh” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 11 të Kodit të Procedurave Administrative, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, kapitullit X të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuar nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, si dhe pikës 2 të nenit 16 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.10.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

duke konsideruar se:

Vendimi 143, datë 22.8.2012 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, reflektonte parimin e barazisë në alokimin e kapaciteteve dhe pagesës përkatëse ndërmjet pjesëtarëve të tregut.

Përfitues nga pika 2 e vendimit 143 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është vetëm një furnizues i kualifikuar.

Furnizuesit e tjerë të kualifikuar i kanë fituar kapacitetet e nevojshme për furnizimin e klientëve të kualifikuar me pagesë në ankandin vjetor të zhvilluar nga ana e OST sh.a.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve,

VENDOSI:

1. Subjektet e përcaktuara sipas detyrimit në pikën 2 të vendimit nr. 143, datë 24.10.2012 “Për kapacitetet e siguruara të interkonjeksionit për muajin nëntor 2012”, do t’i paguajnë OST-së vlerën sipas rezultateve të ankandit vjetor.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve, shoqërinë OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani